



ANALIZË E SHKURTËR

Nr.4/15– Maj 2015

Ky projekt është përkrahur nga Konrad Adenauer Stiftung



Konrad
Adenauer
Stiftung

**Integrimi i partive politike të Kosovës në
organizatat ndërkombëtare të partive politike:
Shpjegimi i vonesës**

Përmbajtja dhe pikëpamjet të shprehura në këtë botim janë të KIPRED-it, dhe nuk mund të merren si pikëpamje të donatorit.

Autor: Mentor Agani

Redaktor: Lulzim Peci

Copyright © 2015, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org apo: +381 38 227 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave

Rr. Rexhep Mala, Nr. 5A

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +381 38 227 778

www.kipred.org

HYRJE

Hulumtimi në vijim, lidhur me anëtarësimin dhe pjesëmarrjen e partive politike të Kosovës në organizatat ndërkombëtare të partive politike, dhe posaçërisht në ato evropiane, e dëshmon faktin që kjo pjesëmarrje dhe ky integrim janë në një nivel fare të ulët. Në fakt, vetëm LDK-ja është anëtare e EPP-së (European People's Parties – Partitë Popullore Evropiane), ndërkaq katër partitë e tjera të shqyrtuara¹ janë në fazat fillestare të aplikimit për anëtarësim në organizata të tilla. Kjo pjesëmarrje dhe integrim i ulët janë të shkaktuara nga paqartësitë lidhur me orientimin ideologjik të partive politike të Kosovës. Ndërkaq, këto paqartësi, më tutje, shpjegohen nga një varg faktorësh historikë që kanë qenë të veçantë për Kosovën. Këta faktorë specifik, që kanë qenë vendimtarë për shfaqjen dhe zhvillimin e partive politike të Kosovës, përvojën e saj e bëjnë të dallueshme nga përvojat përkatëse të vendeve të tjera të ish-blokut komunist.

Në pjesën e parë të këtij punimi do ta jipet një përshkrim i shkurtër i veçantive që i ka patur Kosova në zhvillimin e skenës së vet politike shumëpartiake, dhe që kanë ndikuar në krijimin e gjendjes aktuale. Më pas, do të shikohet gjendja aktuale, dhe kjo do të bëhet duke i shikuar pjesët e statuteve dhe programeve të partive politike të Kosovës që kanë të bëjnë me përkushtimet ideologjike të tyre, si dhe me anëtarësimin e tyre në organizatat ndërkombëtare të partive politike. Kësaj do t'i bashkangjitet edhe një analizë e shkurtër e intervistave lidhur me këto çështje, që i kemi zhvilluar me një numër të zyrtarëve të lartë të këtyre partive. Në pjesën e parafundit do të paraqiten dhe shqyrtohen problemet kryesore të partive politike të Kosovës sa i përket përkushtimeve ideologjike të tyre dhe qëndrimit që e kanë ndaj anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare dhe evropiane të partive politike. Në fund do të jipen disa rekomandime.

1. Specifikat e përvojes historike të artikulimit ideologjik në Kosovë

Specifikat e zhvillimit historik të artikulimit ideologjik në Kosovë do t'i japim për dy periudha: atë para vitit 1989, dhe atë pas vitit 1989.

1. Para vitit 1989 – Përvojat e pjesës më të madhe të vendeve të ish-blokut komunist, në dekadat para vitit 1989² kur ky bllok u shemb, përfshijnë ekzistencën e një partie komuniste në pushtet, dhe të një lëvizjeje shoqërore opozitare që e priste momentin e përshtatshëm për t'u

¹ Partitë e shqyrtuara janë LDK, PDK, AAK, VETËVENDOSJE!, dhe NISMA. Përndryshe, këtu janë marrë parasysh vetëm partitë politike që sot kanë grupe parlamentare. Sikur të shqyrtoheshin edhe partitë e tjera, atëherë partia e parë kosovare që ka arritur të anëtarësohet në ndonjë organizatë ndërkombëtare të partive politike ka qenë Partia Liberale e Kosovës, e cila, që nga vitet 1990 është observere në Internacionalen Liberale, dhe është, po ashtu, anëtare e Partisë së Aleancës së Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën.

² Duke filluar, të paktën, që nga ngjarjet e vitit 1968.

artikular politikisht. Duke qenë anti-komuniste, këto lëvizje shoqërore ishin anti-të-majta, dhe kjo edhe u pasqyrua në ideologjitë e partive që dolën nga to duke filluar nga fundi i viteve 1980. Kjo, më pastaj, e pati ndikimin e vet në shfaqjen dhe zhvillimin e skenave politike shumëpartiake të atyre vendeve.

Për dallim nga kjo, në Kosovë në pushtet ishte Lidhja e Komunistëve Kosovës (pjesë e Lidhjes së Komunistëve të ish-Jugosllavisë), ndërkaq opozita shoqërore ishte e organizuar në grupe ilegale, që në masën më të madhe ishin të frymëzuara nga PPSH-ja – Partia Popullore e Shqipërisë e Enver Hoxhës – domethënë, nga një ideologji komuniste e tipit stalinist. Me fjalë të tjera, si pasojë e rrugëtimit specifik për çlirimin e Kosovës, raporti pozitiv politik/opolitë shoqërore në të nuk ishte midis të të majtës në pushtet dhe të djathtës në shoqëri, por midis dy të majtave, njëres jugosllave, në pushtet, dhe tjetrës të Shqipërisë, në ilegale dhe nëpër burgje.

Pas demonstratave të vitit 1981, lëvizja komuniste e tipit stalinist e rriti ndikimin e vet shumë shpejtë, duke u bërë opozita pothuaj e vetme në mesin e viteve 1980. Mirëpo, ardhja e Millosheviqit në pushtet dhe kërcënimi që kjo ia parashtrroi Kosovës, si dhe parandjenjat që në mesin e shqiptarëve të Kosovës i ndjellën ngjarjet e mëdha që ndodhnin në Evropën Qendrore dhe Lindore, parashtruan nevojën e një rirreshtimi ideologjik të tyre. Ky rirreshtim është dashur që atyre t'u mundësonte, jo vetëm përshtatjen me rrjedhat kryesore evropiane, por, po ashtu, edhe artikulin e një ideologjie anti-të-majtë me të cilën do t'i kundërviheshin Millosheviqit.³

Si pasojë, ndryshimet e dhunshme të Kushtetutës së Kosovës në vitin 1989 bënë që Lidhja e Komunistëve të Kosovës (e majta jugosllave) të shpërbëhej në tërësi brenda një kohe fare të shkurtër, që grupet marksist-leniniste (e majta e frymëzuar nga regjimi i Shqipërisë) të diskreditoheshin në tërësi dhe të braktiseshin nga një pjesë e madhe e përkrahësve të heshtur të tyre, dhe që në skenën politike të Kosovës të shfaqej LDK-ja, që e kishte një përkushtim ideologjik në tërësi të ndryshëm nga ai që paraprakisht mbizotëronte në Kosovë. Kësisoj, ideja për braktisjen e komunizmit në Kosovë u shfaq më vonë se në të gjitha vendet e tjera të ish-bllokut komunist, mirëpo, një herë pasi që kjo u shfaq, braktisja u përfundua shumë më shpejtë, dhe ishte shumë më e plotë, se në ato vende të tjera. Në ato vende të tjera partitë komuniste pas rënies nga pushteti mbetën në opozitë, ndërkaq në Kosovë të dyja trajtat e komunizmit u zhdukën në tërësi.

2. Pas vitit 1989 – Si pasojë e zhvillimeve të brendshme specifike para vitit 1989, në periudhën vijuese Kosova u gjet përsëri në një situatë të veçantë. Kalimi në gjendjen e re ishte përsëri i dallueshëm nga kalimet përkatëse në vendet e tjera të ish-bllokut komunist – nga një gjendje në të cilën e majta ekzistonte, si në pushtet, ashtu edhe në opozitën shoqërore, dhe atë pa kurfarë të djathtë, Kosova kaloi në një gjendje në të cilën e djathta u shfaq, pikërisht në momentin kur e majta u zhduk. Në vend se të kalonte nga sistemi njëpartiak në atë

³ Millosheviqi trajtohej si kundërshtar kombëtar, dhe kjo duhej të përforcohej edhe me një refuzim ideologjik të tij, ndërkaq ideologjia e tij ishte komuniste.

shumëpartiak, Kosova, de facto, kaloi nga një sistem njëpartiak komunist, domethënë i majtë, në një sistem njëpartiak të djathtë. E qartë, shfaqja e partive të reja pas 1989-it ishte e mundshme dhe nuk pengohej nga askush, dhe në këtë periudhë edhe u shfaqën mjaft parti të reja politike. Mirëpo, në zgjedhjet e brendshme që gjatë kësaj periudhe organizoheshin në Kosovë, që të gjitha partitë e tjera së bashku nuk ia dilnin të grumbullonin as 5% të votave, në një situatë kur LDK-ja rregullisht merrte mbi 95% të tyre.⁴ LDK-ja ishte opozitë e pushtetit të Serbisë dhe të Millosheviqit. Sa i përket strukturimit brendakosovar të forcave politike, nuk kishte ende organizime të trajtës pozitë-opozitë, meqë nën tiraninë e regjimit të Millosheviqit shqiptarët që të gjithë ishin bërë një.

Mund të fitohet përshtypja që një kësi strukturimi i skenës politike nuk është i përshtatshëm për përparimin e demokracisë. Mirëpo, mbizotëronin dy faktorë që bënë që demokracia të zhvillohej edhe në këso rrethanash. Së pari, krijimi i partive të reja, jo vetëm që lejohej, por, për më tepër, ishte duke u shndërruar në normë, dhe kjo brenda shoqërisë kosovare e krijoi një tolerancë të brendshme për mendimin ndryshe, madje edhe në situatën kur që të gjithë mendonin njësoj. Dhe, së dyti, përmes dëbimit të shqiptarëve nga të gjitha institucionet politike, regjimi i Millosheviqit ata i hodhi në shoqëri: kësisoj, mënyra e vetme që shqiptarëve u mbeti për artikullimin politik të kërkesave të veta ishte përmes veprimit qytetar, në të cilin ata në periudhën vijuese arritën rezultate të shkëlqyera.

Më parë u përmend që në vitin 1989 u zhdukën që të dyja rrymat komuniste në Kosovë. Këtu Lidhja e Komunistëve të Kosovës u shpërbë për të mos u krijuar përsëri, ndërkaq, grupet ilegale marksiste-leniniste u zhdukën nga skena politike, duke e pritur momentin e përshtatshëm për t'u rishfaqur. Dhe momenti erdhi shumë shpejtë. Rezistenca qytetare paqësore e LDK-së e pësoi një goditje shumë të rëndë në Konferencën e Dejtonit, në të cilën çështja e pavarësimit të Kosovës nuk u mor parasysh fare. Meqë synimi kryesor i rezistencës paqësore të organizuar nga LDK-ja ishte pavarësimi i Kosovës, mospërfshirja e çështjes së Kosovës në Konferencën e Dejtonit grupeve marksiste-leniniste u ofroi mundësi që LDK-në ta paraqisnin si dështim. Këto grupe e shfrytëzuan këtë mundësi, duke e nisur një fushatë propaganduese për ndërprerjen e rezistencës paqësore, dhe për fillimin e rezistencës së armatosur. Kjo çoi në përplasjet e para të armatosura me policinë serbe dhe ushtrinë jugosllave në vitin 1997 dhe në daljen në skenën politike-ushtarake të Kosovës të UÇK-së. Në mesin e udhëheqësve të saj ishte një numër mjaft i madh i atyre që mllëfin ndaj LDK-së e kishin po aq të madh sa edhe mllëfin ndaj Serbisë. Faktikisht, shfaqja e UÇK-së e shënoi jo vetëm fillimin e luftës kundër Serbisë, por edhe krijimin e parakushteve për skenën politike shumëpartiake në Kosovën e pasluftës.

Si përmbledhje, specifikat e përvojës kosovare në krijimin e sistemit shumëpartiak janë këto në vijim:

⁴ Zgjedhjet brendakosovare të organizuara në Kosovë kundërshtoheshin nga Serbia, ndërkaq bashkësia ndërkombëtare ato të shumtën i injoronte.

1. Viti 1989 nuk e shënoi kalimin e Kosovës nga sistemi njëpartiak në atë shumëpartiak, por shembjen e plotë të komunizmit, dhe kalimin nga një sistem njëpartiak komunist të majtë,⁵ në një sistem njëpartiak të djathtë. Pushteti i LDK-së nga viti 1989 deri në vitet 1995-99 mbështetej në autoritetin që kjo e kishte në shoqëri, dhe ky nuk ishte pushtet i mirëfilltë, institucional.

2. Dalja e UÇK-së në skenën politike kosovare i krijoi parakushtet për sistemin e mirëfilltë shumëpartiak të pasluftës në Kosovë. Meqë udhëheqësia e UÇK-së ishte në masën më të madhe e majtë, skena politike shumëpartiake në Kosovë nuk u krijua nga përpjekjet e rrymave të djathta për ta hequr nga pushteti të majtën, por nga përpjekjet e të majtës për ta hequr nga pushteti të djathtën.⁶

3. Edhe përkundrejt përkushtimit mjaft të fuqishëm ideologjik të një numër u udhëheqësve të të dyja këtyre rrymave politike, rrethanat e viteve 1995-1999 bënë që gara politike fillestare të përqëndrohej, jo në çështjet ideologjike, por në dështimin e palës tjetër në përpjekjet për ta zgjidhur çështjen kombëtare. Kjo trajtë e garës politike vazhdoi edhe pas luftës, kur skena politike shumëpartiake tashmë ishte krijuar – argumentimi politik i partive politike në Kosovën e pasluftës nuk ishte i trajtës “ideologjia ime është më e mirë se e jotja,” por i trajtës “ju nuk jeni të denjë të jeni në pushtet, meqë rezistenca juaj ka dështuar ta çlirojë Kosovën nga Serbia.” Dhe në këtë trajtë argumentimi, që të dyja rrymat kishin të drejtë: çdonjëra prej tyre kishte dështuar në përpjekjet për ta çliruar Kosovën nga Serbia, gjë kjo që edhe e shkaktoi katastrofën humanitare që e nxiti intervenimit ushtarak të NATO-s që e çliroi Kosovën nga Serbia.

2. Aspektet statutoare dhe programore që kanë të bëjnë me ideologjitë e partive të Kosovës dhe me anëtarësimin e tyre në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të partive politike

Trajtimet e deritashme hyrëse kishin për qëllim t'i ofrojnë disa shpjegime fillestare që do ta mundësojnë të kuptuarit e shkaqeve të profilizimit mjaft të vonuar ideologjik të partive politike të Kosovës. Kosova, siç pamë, ishte në një situatë ku tranzicioni në demokraci dhe krijimi i sistemit shumëpartiak duhej të bëheshin paralelisht me çlirimin, pavarësimin dhe shtetndërtimin e saj. Si pasojë, këtu kishte ndërhyrje të çështjeve që kishin të bënim me këto dy synime në njëra-tjetrën. Kjo, mes tjerash, bëri që të krijoheshin një situatë ku përkushtimet ideologjike mjaft shpesh flijoheshin kur puna vinte te çështjet që konsideroheshin si madhore. Mirëpo, duhet theksuar që, fatkeqësisht, ky flijim, që fillimisht ushtrohej lidhur me çështjet që

⁵ Siç u përmend, këtu ishin dy rryma komuniste, ajo jugosllave, dhe ajo e frymëzuar nga regjimi i Shqipërisë, mirëpo, vetëm Lidhja e Komunistëve të Kosovës ishte e organizuar si parti institucionale.

⁶ Kjo karakteristikë e përvojës së Kosovës atë e dallon nga të gjitha vendet e tjera ish-komuniste. Në të gjitha ato vende kalimi në sistemin qeverisës shumëpartiak në vitin 1989 erdhi me shembjen e të majtës nga ana e të djathtës.

Po e theksojmë përsëri që pushteti në këtë fjali nuk e shënon pushtetin e mirëfilltë shtetëror institucional – në këtë periudhë Kosova ende nuk ishte shtet – por pushtetin autoritativ.

konsideroheshin madhore, me kalimin e kohës filloi t'i marrë tiparet e një kulture politike edhe për çështjet që ishin minore.

Në vazhdim do të përqendrohemi në mënyrën si janë të trajtuara në statutet dhe programet e partive kryesore politike që janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, aspektet ideologjike dhe ato që kanë të bëjnë me anëtarësimin e tyre në organizimet dhe asociacionet evropiane dhe ndërkombëtare të partive politike.

Duke u bazuar në statutet dhe programet e partive politike të shqyrtuara, si dhe në theksimin e tyre në intervistat e zhvilluara me përfaqësues të lartë të tyre,⁷ shihet që profilizimi ideologjik formal i tyre është i trajtësuar dhe i shprehur mjaft qartë. Mirëpo, duke u bazuar në përvojën e zhvillimeve politike të pasluftës në Kosovë, është një përshtypje mjaft e shprehur që ekziston një prirje mjaft e fuqishme në disa nga këto parti që t'i flijojnë përkushtimet e veta ideologjike me qëllim të marrjes së pushtetit. Përvoja historike e pasluftës ka dëshmuar në disa raste rirreshtime ideologjike të mëdha në partitë e Kosovës. Kështu, PDK, nga një parti që menjëherë pas luftës doli si parti e qendrës së majtë, në ndërkohë është shndërruar në parti të qendrës së djathtë. Nga ana tjetër, AAK, në zgjedhjet e para pas luftës ka hyrë me një refuzim të plotë të përkushtimit ideologjik, duke e përvetësuar slogonin zgjedhor "As majtas, as djathtas, por përpara," ndërkaq sot është parti e qendrës së djathtë. Ndërkohë që në partitë e tjera nuk ka patur kësi kapërcimesh evidente, do të shohim që edhe te disa prej tyre ka patur aspekte të qeverisjes që kanë qenë mjaft problematike sa i përket përkushtimit ideologjik.

Përndryshe, tri nga pesë partitë e shqyrtuara përcaktohen si parti të qendrës së djathtë (PDK, LDK dhe AAK), dhe dy janë të qendrës së majtë (VETËVENDOSJE! dhe NISMA). Përkushtimet vlerore të partive të qendrës së djathtë, që janë theksuar edhe në intervistat e zhvilluara, janë ato ndaj familjes, pronës private dhe derregullimit të ekonomisë, të besimit në zot, të përkushtimit ndaj individit, etj. Ndërkaq, ato të partive të qendrës së majtë janë shteti zhvillimor, pronësia publike në sektorët strategjikë, liria kolektive si parakusht i lirisë individuale, roli i politikave fiskale në zgjidhjen e problemit të papunësisë, etj. Po ashtu, partitë e qendrës së majtë e konsiderojnësi të domosdoshme ndërprerjen e udhëheqjes së Kosovës nga partitë e djathta, udhëheqje kjo që ka vazhduar pandërprerë që nga çlirimi e këndeje.

Në vazhdim po i përmendim vetëm disa të dhëna themelore statutores dhe programore për çdonjërin nga këto parti, që kanë të bëjnë me ideologjitë e partive dhe me anëtarësimin e tyre në organizimet ndërkombëtare të partive politike.

PDK – Në Statutin e vet, PDK veten e përcakton si parti popullore,⁸ që në aspektin ideor është parti e qendrës së djathtë, dhe që anëtarësohet në asociacione dhe në organizata të tjera

⁷ Përfaqësuesit e intervistuar të partive të shqyrtuara janë: Teuta Sahatçija, LDK, Zenun Pajaziti, PDK, Ardian Gjini, AAK. Bojken Abazi, VETËVENDOSJE! dhe Jakup Krasniqi, NISMA.

⁸ Statuti i PDK, Neni 1. Ky është Statuti i vitit 2013 i PDK, ku ky Nen thotë: "Partia Demokratike e Kosovës është parti popullore e themeluar mbi vlerat tradicionale, kombëtare, vlerat e luftës çlirimtare dhe vlerat universale të demokracisë qytetare." Ky Nen është ndryshuar nga Neni 1 i Statutit të vitit 2005, për ta reflektuar rirreshtimin e rirreshtimin ideologjik të përmendur më sipër. Përndryshe, Neni 1 i Statutit të vitit 2005 të PDK thotë: "Partia

politike ndërkombëtare, që kanë synime dhe orientime të ngjashme politike dhe programore.⁹ Sa i përket vlerave të përmendura në Programin e PDK-së, ato që janë të shënuara dhe që kanë të bëjnë me rreshtimin ideologjik janë të drejtat dhe liritë e njeriut sipas standardeve ndërkombëtare (dhe këtu përmenden e drejta e informimit, liria e shprehjes së mendimit, liria e shtypit dhe mediave, e bindjes dhe e fesë, paprekshmëria e pronës, liria e lëvizjes, etj.), toleranca dhe mirëkuptimi ndëretnik, ekonomia e tregut, etj.¹⁰ Përndryshe, në Program theksohet edhe përkushtimi për integrimet shqiptare në rajon dhe në Evropë, si dhe për integrimin e Kosovës në institucionet evropiane.¹¹

LDK – Edhe LDK në Statutin e vet përcaktohet si parti e qendrës së djathtë që bashkëpunon me parti dhe organizime të tjera politike dhe jopolitike në vend dhe jashtë vendit.¹² LDK-ja mund të bashkëpunojë dhe të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare politike që kanë aspirata të ngjashme programore.¹³ Sa i përket vlerave të cekura në Program, LDK është e përkushtuar ndaj vlerave të lirisë, të familjes dhe të mbrojtjes së saj, sundimit të ligjit, etj.¹⁴ Lidhur me anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare të partive politike, Programi i LDK-së thekson që integrimi i Kosovës në BE është jetik për qytetarët dhe shtetin e Kosovës, “dhe beson që ‘evropianizimit’ të Kosovës duhet t’i prijë ‘evropianizimi’ i partive politike, institucioneve dhe shoqërisë kosovare.”¹⁵

AAK – Përkushtimet themelore formale ideologjike të AAK-së janë të përcaktuara në Platformën Programore të saj, ku thuhet që “AAK është parti e qendrës së djathtë,”¹⁶ dhe pak më vonë: “Si parti e qendrës së djathtë ne krijojmë dhe promovojmë lirinë e individit, lirinë e iniciativës, lirinë e shprehjes, të besimit dhe të konkurrencës në të gjitha fushat e jetës. Ne jemi të bindur se me individ të lirë do të kemi shoqëri të lirë, shtet të zhvilluar dhe demokraci stabile.”¹⁷ Këtu, po ashtu, përcaktohet edhe përkushtimi i AAK-së për të qenë pjesë e Partive Popullore Evropiane.¹⁸ Vlerat e tjera të cekura në këtë platformë janë ato të traditës, të drejtat

Demokratike e Kosovës (PDK) është parti politike, e pavarur dhe unike, e anëtarëve, të cilët organizohen dhe veprojnë me qëllim të përmbushjes së detyrave programore.”

⁹ Statuti i PDK, Neni 8. Vlen të theksohet që përcaktimi i PDK si parti popullore me mjaft gjasë ka të bëjë me synimin e PDK për t’u anëtarësuar në organizatën e partive popullore të Evropës.

¹⁰ Të marra nga Programi i PDK.

¹¹ *Ibid.*

¹² Statuti i LDK, Nenet 2 dhe 3.

¹³ Statuti i LDK, Neni 15.

¹⁴ Programi i LDK.

¹⁵ *Ibid.*

¹⁶ Platforma Programore e AAK.

¹⁷ *Ibid.* Është interesante që Platforma Programore e AAK e paraqet të vetmin program të partive kosovare të qendrës së djathtë që në një mënyrë më të qartë dhe më të hollësishme përqendrohet në konkurrencën si një nga vlerat më të rëndësishme ‘të djathta.’

¹⁸ *Ibid.*

e njeriut, prona private dhe mbrojtja e saj, ekonomia e tregut të lirë, familja, toleranca ndërfaqetare, etj.¹⁹

VETËVENDOSJE! – Lëvizja VETËVENDOSJE! përkushtimin e vet të qendrës së majtë e ka të shprehur, por jo edhe të përcaktuar në trajtë formale në Statutin dhe në Programin e vet. Në Statut flitet për mundësinë e bashkëpunimit politik me subjekte dhe organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare sindikaliste, studentore, politike dhe organizata joqeveritare, që mund të vendoset në katër mënyra: me marrëveshje bashkëpunimi rreth çështjeve të veçanta, me anëtarësim në rrjete dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, me shkrirje dhe me koalicione parazgjedhore dhe qeveritare.²⁰ Përkushtimet vlerore kryesore të përmendura janë ato ndaj të drejtave të njeriut, të pakicave, lirisë së shtypit, të drejtave fetare, të barazisë gjinore, etj.²¹ Po ashtu, është për t'u përmendur edhe mënyra si shprehet përkushtimi ndaj ligjit, ku thuhet që "Askush në Kosovë nuk mund të jetë mbi ligjin. ... Asnjë qytetar e asnjë komunitet nuk bën të lirohet nga obligimi për ta respektuar ligjin ...".²²

NISMA – NISMA është parti e re e qendrës së majtë që ende nuk i ka mbajtur mbledhjet e para të Këshillit të përgjithshëm ku do të aprovohejshin trajtat përfundimtare të Statutit dhe Programit të saj. Rrjedhimisht, kjo vepron duke u mbështetur në trajtën fillestare të programit të vet.²³ Edhe pse në të nuk thuhet asgjë eksplicite për ideologjinë dhe përkushtimin për anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare, përcaktimi i majtë i NISMA-s është i dhënë në mënyrë të tërthortë. Kështu, për shembull, në këtë program theksohet që arritjet e Bashkimit Evropian janë rezultat i ekonomisë së tregut, por edhe i garantimit të të drejtave sociale. Prandaj "për ta ndërtuar Kosovën mbi këto parime, NISMA angazhohet që ekonomia jonë të bazohet në struktura të mirëfillta të tregut, dhe në të njëjtën kohë të merren parasysh dimensionet social e humanitar ...".²⁴

3. Çështjet kryesore lidhur me anëtarësimin e partive politike të Kosovës në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të partive politike – këndvështrimi brendapartiak

Gjendja e tashme në Kosovë lidhur me anëtarësimin e partive politike të Kosovës në organizimet evropiane dhe ndërkombëtare të partive politike është ajo që LDK-ja është partia e vetme në Kosovë që është anëtare e një organizimi të tillë – kjo është anëtare e EPP-së, Partisë Popullore të Evropës. Partitë e tjera, edhe përkundrajt përcaktimeve statutoare dhe programore, si dhe të përkushtimeve të tyre, nuk janë anëtare të organizatave të ngjashme. Disa nga këto

¹⁹ *Ibid.*

²⁰ Statuti i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, Bashkë në organizim, bashkë në veprim, Neni 11, Paragrafi 1.

²¹ Programi i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, Zhvillim dhe shtetndërtim: Bashkë është e mundshme, Pika 18, fq. 11.

²² *Ibid.*, Pika 21, fq. 12.

²³ Ky i ka gjithsej 4 faqe.

²⁴ Programi fillestar i NISMA-s.

parti të tjera kanë shprehur dëshirë, disa kanë patur kontakte, dhe disa aplikuar për anëtarësim në organizata të tilla, por asnjëra nga to deri tash nuk ka patur sukses në këtë synim. Në vazhdim po japim një përshkrim dhe disa shpjegime të shkurtëra të kësaj gjendjeje, ashtu siç këto janë përmendur në intervistat e zhvilluara me zyrtarë të lartë të këtyre partive.

PDK-ja, si parti që është e qendrës së djathtë, ka aplikuar për anëtarësim në EPP, dhe kjo ka patur takime lidhur me këtë, por ende nuk e ka arritur anëtarësimin formal.²⁵ Qëllimi i përmendur i këtij anëtarësimi, përpos njohjes së Kosovës dhe avancimit të PDK-së, është edhe mundësia e ndikimit në vendimet e shteteve anëtare të BE-së. Për këto dobi të anëtarësimin, si për Kosovën, ashtu edhe për PDK-në, është një vetëdije në rritje në mesin e antarësisë dhe përkrahësve të PDK-së, dhe kjo rritje është e ndërlidhur edhe me vetëdijen për domosdonë e përfshirjes së Kosovës në proceset integruuese evropiane.²⁶ Problemi kryesor në këtë rrugë ka patur të bëjë me profilizimin mjaft të vështirë dhe të ngadaltë politik të partive politike të Kosovës, dhe me përfshirjen e faktorëve esencialë që ndikojnë në këtë profilizim, si arsimit, çështjet sociale, shëndetësia, etj.

Sa i përket zhvendosjes ideologjike të PDK-së dhe kalimit të saj nga pozita e qendrës së majtë në atë të qendrës së djathtë, ndikimin kryesor në këtë e ka patur fakti që në një pjesë të madhe të popullatës së Kosovës e majta është identifikuar me Serbinë e Millosheviqit, gjë kjo që ka shkaktuar komprometim të saj në sytë e një numri të madh të njerëzve, dhe, në këtë mënyrë, ka qenë një pengesë shumë e madhe në profilizimin politik të partive politike të Kosovës.²⁷ Nga ana tjetër, duke hyrë në qeverisjen e vendit në vitin 2007, PDK-ja e ka patur të qartë që do të jetë e domosdoshme që t'i zbatojë disa politika që për nga natyra janë të djathta, si, për shembull, procesin e privatizimit.²⁸ Po ashtu, një faktor tjetër që është përmendur është edhe fakti që partitë politike të majta të Serbisë që janë anëtare të strukturave evropiane dhe ndërkombëtare të majta, e kanë një ndikim të madh në ato struktura, dhe këtë e shfrytëzojnë për ta penguar anëtarësimin e partive të majta të Kosovës në to. Sidoqoftë, duket sikur kohëve të fundit ka tendenca të profilizimit të përshpejtuar, dhe kjo ndërlidhet si me shkëputjen nga e kaluara, ashtu edhe me hapjen gjithnjë e më të madhe ndaj proceseve të jashtme.²⁹

Siç u tha, e vetmja parti politike në Kosovë që është e anëtarësuar në organizatat evropiane të partive politike është LDK-ja. Kjo e ka statusin e observerit në EEP, Partia Popullore Evropiane, që e ka fituar në tetorin e vitit 2012, në mbledhjen e Bukureshtit të EPP-së.³⁰ LDK-ja e thekson nevojën për përfaqësim sa më të madh në sa më shumë organizata, jo vetëm në EPP, dhe e cek edhe bashkëpunimin që e ka me Jarl Hjalmarson Foundation, me Robert Schumann

²⁵ Intervistë me Zenun Pajazitin, zyrtar i lartë në PDK.

²⁶ *Ibid.*

²⁷ *Ibid.*

²⁸ *Ibid.*

²⁹ *Ibid.*

³⁰ Intervistë me Teuta Sahatçijën, zyrtare e lartë e LDK-së.

Foundation, me Konrad Adenauer Stiftung (KAS), etj.³¹ Përfitimi nga kjo anëtarësi është i madh, dhe atë jo vetëm si parti: kjo anëtarësi mundëson koordinimin mes partive, bashkëpunimin mes tyre, bashkëpunimin e të rinjve, mundësinë e ndikimit në politikat e atyre shteteve partitë e të cilave janë anëtare, etj. Si rezultat i kësaj, LDK-ja e thekson ndikimin që e ka patur në Parlamentin Evropian, si dhe atë gjatë përvetësimit të pikave të Bundestagut gjerman për Serbinë.³² Këtu është përmendur, po ashtu, përfshirja e qytetarisë dhe e rinisë në trajnime, bursa për akademitë partiake, dhe në veprimet e mëtejme me partitë e organizatat simotra.³³ Kështu, për shembull, ka patur avancime në bashkëpunimin e rinisë me jashtë, dhe rinia e LDK-së është pjesë e IES³⁴ dhe e organizatave të ndryshme studentore. LDK-ja e thekson nevojën për përfaqësim sa më të madh në sa më shumë organizata, duke shtuar që përfaqësimi në vetëm një organizatë nuk është benefit, por hendikep për Kosovën.³⁵

AAK-ja nuk është anëtare e organizatave ndërkombëtare dhe evropiane të partive politike. Orientimi i saj është kah partitë popullore, më konkretisht kah EPP-ja. Lidhur me këtë, AAK-ja ka patur bisedime edhe me KAS-in.³⁶ Kjo ende nuk ka aplikuar për anëtarësim në EPP, por theksohet që ekziston vetëdije në rritje në mesin e anëtarësisë për interesin dhe dobinë e këtij anëtarësimi. Dobia e synuar e kësaj ka të bëjë jo vetëm me procesin integruar, por edhe në demokratizimin e brendshëm. Dhe, si shtesë, anëtarësimi në këto organizata do t'i krijonte kushtet për përfundimin e profilizimit të partive politike në Kosovë.³⁷ Utilizimi i një anëtarësimi të tillë të AAK-së në të ardhmen do të bëhej, para së gjithash, për ekspertizën e domosdoshme nga partitë simotra evropiane, si dhe për avancimin e mëtutjeshëm të çështjes së Kosovës.³⁸

As Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk është anëtare e organizatave ndërkombëtare të partive politike, dhe një ndër arsyt kryesore që jipen për këtë është në përpjekjet e faktorëve të ndryshëm ndërkombëtarë për ta penguar anëtarësimin e saj në to.³⁹ Si organizata të synuara përmenden para së gjithash Internacionalja Socialiste dhe Aleanca Progresive, dhe thuhet që kohëve të fundit ka patur përparime: nëse përpara nuk na takonin, komentohet me paksa cinizëm, tash na takojnë.⁴⁰ Po ashtu, ka patur përpjekje për vendosjen e bashkëpunimit me partitë e veçanta, si me Laburisten në Britaninë e Madhe, me socialdemokratët suedezë e norvegjezë, si dhe me partitë e majta franceze. Theksohet, po ashtu, edhe dëshira për socialdemokracinë ballkanike.⁴¹

³¹ *Ibid.*

³² *Ibid.*

³³ *Ibid.*

³⁴ IES – Illuminating Engineering Society.

³⁵ *Ibid.*

³⁶ Intervistë me Ardian Gjinin, zyrtar i lartë i AAK-së.

³⁷ *Ibid.*

³⁸ *Ibid.*

³⁹ Intervistë me Bojken Abazin, zyrtar i lartë në Lëvizjen VETËVENDOSJE!.

⁴⁰ *Ibid.*

⁴¹ *Ibid.*

Benefiti i synuar që mund të arrihet nga anëtarësimi potencial në struktura të tilla ndërkombëtare, si dhe nga bashkëpunimet e përmendura, qëndron në avancimin e çështjes së Kosovës, në mundësinë e shkëmbimit të përvojave, në pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme, në hapësirën më të madhe mediale, si për VETËVENDOSJEN!, ashtu edhe për Kosovën, në heqjen e etiketave që iu janë mveshtur VETËVENDOSJES!, etj. Përmendet edhe aplikimi që do të ndodhë shumë shpejtë për anëtarësim në Internacionalen Socialiste, ku kjo do të bëhet së bashku me Partinë Socialiste të Shqipërisë.⁴²

NISMA është një parti e re që ende nuk e ka mbajtur kongresin e vet të parë ku do të vendosej për komunikimet me partitë dhe organizatat partiake të tjera të majta, por kjo gjithsesi synon që të ketë komunikime të tilla.⁴³ Një kësi komunikimi me partitë dhe me organizatat partiake të majta të Evropës është tejet i rëndësishëm, duke e patur parasysh ndikimin që partitë e majta e kanë në Evropë. Mbi të gjithat, një komunikim dhe bashkëpunim i tillë do të mundësonte që zëri i Kosovës të dëgjohet në Parlamentin Evropian.⁴⁴ Qytetarët janë për integritime evropiane edhe të partive politike, mirëpo kjo kërkon vlera të caktuara që në Kosovë janë mjaft problematike. Në mesin e këtyre vlerave përmenden mbi të gjithat mënyra demokratike e funksionimit të partive politike, si dhe sundimi i ligjit dhe pavarësia e gjyqësorit. Është e domosdoshme, jo të flitet për integritime, por të përvetësohen standardet e tyre.⁴⁵ Edhe këtu përmendet dëmtimi që ia ka shkaktuar të majtës në Kosovë SPS-i i Serbisë dhe theksohet që një pjesë e madhe e popullatës së Kosovës nuk ia ka dalë ta bëjë dallimin midis socializmit dhe nacionalizmit.⁴⁶

4. Mbi shkaqet e vonimit të anëtarësimit të partive politike të Kosovës në strukturat dhe asociacionet evropiane dhe ndërkombëtare të partive politike

Deri këtu i kemi shqyrtuar disa aspekte historike të zhvillimeve ideologjike në Kosovë në periudhën para luftës, mënyrën si janë të përcaktuara në statutet dhe programet e partive politike të Kosovës përkushtimet e tyre ideologjike si dhe ato për anëtarësim në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të partive politike, si dhe përpjekjet e tyre të tashme dhe të deritashme për anëtarësim në organizata dhe asociacione të tilla. Në këtë mënyrë i kemi faktet kryesore të nevojshme për të kuptuar gjendjen dhe problemet aktuale me të cilat përballen partitë kosovare sa i përket integritimit të tyre në strukturat partiake evropiane dhe

⁴² *Ibid.* Përndryshe, Kryeministri i tashëm i Shqipërisë, Edi Rama, është njëri ndër nënkryetarët e shumtë të Internacionales Socialiste.

⁴³ Intervistë me Jakup Krasniqin, Kryetar i NISMËS.

⁴⁴ *Ibid.*

⁴⁵ *Ibid.*

⁴⁶ *Ibid.* SPS – Partia Socialiste e Serbisë, ish-partia e Millosheviqit.

ndërkombëtare, si dhe vonesën e konsiderueshme të tyre për t'u anëtarësuar në këto struktura.

Problemet kryesore të identifikuar nga KIPRED-i që e kanë shkaktuar vonesën në anëtarësimin e partive politike kosovare në strukturat dhe asociacionet evropiane dhe ndërkombëtare të partive politike janë dy.

1. Problemi i parë qëndron në profilizimin e vonuar ideologjik të partive politike në Kosovë.

2. Problemi i dytë është vonesa e partive politike kosovare në të kuptuarit e rëndësisë dhe të dobisë nga anëtarësimi në struktura dhe asociacione të tilla.

Në vazhdim po i diskutojmë disa nga faktorët më të rëndësishëm që e kanë patur ndikimin më të madh në shfaqjen e këtyre dy problemeve, ashtu që të fitohet një përshtypje për hapat që duhen ndërmarrë për tejkalimin e tyre.

A. Siç u përmend në seksionin e parë, rreshtimet ideologjike brenda skenës politike kosovare rrodhën për një kohë shumë të gjatë paralelisht me përpjekjet e Kosovës për t'u çliruar dhe pavarësuar nga Serbia, dhe, pas kësaj, me përpjekjet e saj për shtetndërtim. Kjo e krijoi një situatë ku përkushtimet ideologjike shumë shpesh flijoheshin për qëllime të tjera që konsideroheshin më madhore. Thjeshtë, prioritetet e çlirimit, pavarësimit, dhe të shtetndërtimit, shumë herë i lanë anash çështjet ideologjike. Kjo ndikoi fuqishëm në krijimin e një kulture politike ku ideologjia, në vend që të konsiderohet si qëllim në vetvete, filloi gradualisht të merrej vetëm si një mjet për përmbushjen e qëllimeve të tjera. Kjo edhe e shpjegon faktin që në vitin 1989, në kohën kur anembanë Evropës Qendrore dhe Lindore komunizmi shembej, në Kosovë ai nuk u shemb, por u zhduk fare. Duke e marrë parasysh përbuzjen e krijuar për komunizmin anembanë, si dhe faktin që Serbia në atë kohë udhëhiqej nga Millosheviqi që kishte dalur nga Lidhja e Komunistëve e majtë, popullata e Kosovës e ndërmori në një mënyrë spontane hapin e kthimit të vrullshëm dhe të plotë kah e djathta, që, mes tjerash, asaj i mundësoi që armikun kombëtar ta paraqiste edhe si armik ideologjik, dhe, për më tepër, si një armik ideologjik që ishte i përkushtuar ndaj ideologjisë së gabuar.

Lënia anash e ideologjisë në çështjet politike brendakosovare mbase edhe ka mundur të kuptohet dhe arsyetohet në situatën kur ideologjia flijohej për hir të çështjeve të çlirimit, pavarësimit dhe të shtetndërtimit. Mirëpo, këto lëshime ideologjike për hir të çështjeve madhore kombëtare dhe shtetërore, me kalimin e kohës kaluan në lëshime për hir të çështjeve më minore, ku kryesorja midis tyre ishte ardhja dhe/ose mbetja në pushtet. Kësisoj, te partitë politike të Kosovës, sot përkushtimet ideologjike, qofshin ato statutore, programore, normative, apo të tjera, bijnë në tërësi kur çështja vjen tek ardhja apo mbetja në pushtet. Sa për ilustrim të jokonsekuencës ideologjike të partive politike të Kosovës, po i japim vetëm dy shembuj, por që janë tejet domethënës.

Të gjitha partitë që e kanë udhëhequr qeverinë e Kosovës në periudhën e pasluftës sot veten e përcaktojnë si parti të qendrës së djathtë. Mirëpo, sot në Kosovë mbretëron një situatë ku paga mesatare në sektorin shtetëror dhe publik është 441€, ndërkaq në sektorin privat kjo

është 228€. ⁴⁷ Sikur partitë e qendrës së djathtë të Kosovës që e kanë udhëhequr qeverinë e Kosovës në periudhën e pasluftës të kishin qenë vërtetë konsekuente ndaj qendrës së djathtë, raporti i pagave të sektorit shtetëror dhe publik ndaj atyre të sektorit privat do të kishte qenë i anasjelltë ndaj raportit ekzistues. Kësisoj, për shkak të jokonsekuencës ideologjike të partive politike të saj, Kosova, pas një qeverisjeje prej rreth një dekade e gjysmë nga ana e partive të djathta, e ka krijuar një gjendje ku sektori privat trajtohet në një mënyrë tejet të majtë.

Dhe, shembulli i dytë, dihet që partitë e djathta janë të përkushtuara për forcimin e biznesit, dhe për reduktimin e rolit të shtetit në ekonomi. Rrjedhimisht, partitë e djathta pothuaj rregullisht e synojnë uljen e buxhetit shtetëror. Ndërkaq, në Kosovë, gjatë një dekade e gjysmë të qeverisjes së djathtë, buxheti shtetëror është rritur pandërprerë. Në sektorin e biznesit është shumë e përhapur përshtypja që rritja e buxhetit shtetëror në Kosovë nuk është e kufizuar nga nevojat e udhëheqjes, por vetëm nga mundësitë për t'i marrë biznesit, ashtu që t'i jipet shtetit. Dhe, për më tepër, shumica e biznesmenëve kosovarë janë të bindur që qeveritarët e Kosovës buxhetin e rritin jo për arsye të zbatimit të politikave sociale dhe të mirëqenies, por vetëm me qëllim të madh shtetëror atyre u ofron mundësi më të mëdha për t'u korruptuar.

Ajo se çfarë mund të jetë arsyeja e një kësi trajtimi kaq mizor të biznesit dhe të sektorit privat nga qeveritë e njëpasnjëshme të djathta të Kosovës, është diçka që mund vetëm të spekulohet, dhe, po ashtu, një temë trajtimi i të cilës do t'ia vlente. Por, ajo që është e qartë është që shpërputhjet kaq të mëdha midis sjelljeve të partive politike të Kosovës kur ato e marrin pushtetin, dhe ideologjive të tyre të deklaruara e paraqesin gjithsesi një pengesë shumë serioze për profilizimin ideologjik të tyre, që është aq i domosdoshëm për anëtarësimin e tyre në organizimet evropiane dhe ndërkombëtare të partive politike.

B. E ndërlidhur me këtë është edhe pozita jashtëzakonisht e dobët e të majtës në Kosovë, që është përmendur më sipër tërthorazi, dhe që është trashëguar që nga periudha para luftës. Siç u përmend, rënia e komunizmit në Evropën Qendrore dhe Lindore, në Kosovë u përcjell me zhdukjen e përkohshme të të majtës, që u kompensua në vitet 1997-1999 me një ripertëritje të pjesshme të saj. Mirëpo, që nga ajo kohë, kjo ripertëritje asnjë herë nuk e arriti nivelin që e majta ta merrte pushtetin. E vërtetë, në vitin 2007 qeverinë e mori PDK-ja, që në atë kohë, nga aspekti statutor dhe programor, ende ishte parti e qendrës së majtë; mirëpo, procesi i shndërrimit të saj në parti të qendrës së djathtë tashmë kishte filluar, dhe ajo në zgjedhjet e mëpasme ishte e artikuluar si e djathtë.

Si pasojë, tri partitë e qendrës së djathtë ⁴⁸ në zgjedhjet e fundit të vitit 2014 e kanë fituar pothuaj shumicën absolute të votave, gjithsej 65.16%. ⁴⁹ Ndërkaq, dy partitë e qendrës së majtë

⁴⁷ KIPRED Policy Paper No. 1/15, "Kosovo to EU: The Challenge of Irregular Migration," fq. 7. Cituar nga: Kosovo Agency of Statistics quoted in Koha Ditore Article "Sektori privat me paga më të ulëta se sektori publik", 16 November 2014 at <http://koha.net/?id=27&l=33465> See also Report "Business Climate in Kosovo – A cross-regional perspective, Riinvest Institute, pg. 29, at http://ëëë.riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/Business_Climate_in_Kosovo_1421852590.pdf

⁴⁸ PDK, LDK dhe AAK.

i kanë fituar së bashku 18.74% të votave.⁵⁰ Për më tepër, sot Kosova qeveriset nga një aleancë e dy partive të qendrës së djathtë, PDK dhe LDK, që së bashku i kanë 55.62% të votave, ndërkaq, opozita është një aleancë që përbëhet nga dy parti të qendrës së majtë (VETËVENDOSJE! dhe NISMA) me një parti të qendrës së djathtë (AAK), që së bashku i kanë fituar 28.22% të votave. Domethënë, e majta në opozitë, madje edhe kur është së bashku me AAK-në si parti e qendrës së djathtë, i ka pak më tepër se një të katërtën e votave, ndërkaq e djathta në qeverisje, madje edhe pa AAK-në, e tejkalon në një masë të konsiderueshme gjysmën e votave: ndërkaq, po t'i shtohet edhe AAK-ja, e djathta do të ishte fare pranë shumicës absolute prej dy të tretave. E qartë, është edhe pjesa e votuesve të Kosovës që kanë votuar për parti të tjera, dhe këto parti të tjera i kanë fituar 16.1% të votave. Mirëpo, shumica prej tyre nuk kanë qenë aq 'parti ideologjike,' sa parti të minoriteteve të përkushtuara për avancimin e pozitës së grupeve të tyre etnike.⁵¹

Shkaku i kësaj dobësie të të majtës në Kosovë është përmendur më parë. Në vitin 1989, shqiptarët e Kosovës e kanë braktisur, jo vetëm komunizmin, por edhe vetë idenë e të majtës, ashtu që komunizmin dhe të majtën t'ia linin si një 'kopil tek dera' Serbisë dhe regjimit të Millosheviqit. Ideja e socializmit, e socialdemokracisë, etj., që nga ajo kohë ishte ide e 'ideologjisë së gabuar,' që mund të përqafohej si vlerë vetëm nga një shtet çfarë ishte Serbia e Millosheviqit. Kjo vështirësi e të majtës është përmbledhur shumë mirë nga njëri ndër përfaqësuesit e lartë të partive të majta, që në njërin nga intervistat e zhvilluara për qëllimet e këtij hulumtimi thotë: "SPS-i i Millosheviqit ka ndikuar jashtëzakonisht shumë në rritjen e urrejtjes ndaj socializmit dhe socialdemokracisë tek një pjesë e madhe e shqiptarëve të Kosovës. Fatkeqësisht, një numër i madh i shqiptarëve të Kosovës nuk ia ka dalë ta bëjë dallimin midis socializmit dhe nacionalizmit."⁵² Këtu duhet shtuar edhe atë që popullata e Kosovës, si pasojë e specifikave të zhvillimit të saj historik, është mjaft e prirur që në aspektin vleror të jetës së përditshme, të jetë, jo aq konservatore, sa tradicionaliste. Kjo u shpreh shumë mirë nga një përfaqësuese e partive të qendrës së djathtë, që në intervistën e zhvilluar me të thotë: "Shumica e qytetarëve të Kosovës kanë vlera të djathta, por ata këto vlera nuk i perceptojnë si tregues të asaj që kanë ideologji të djathtë. Nëse shqiptarët e Kosovës nuk i prek në familje, në pronë dhe në zot, punët me ta do t'i kesh për mrekulli. Këto janë vlera të djathta, por ata këto nuk i shohin si të djathta, por si normale."⁵³

⁴⁹ PDK i ka fituar 30.38%, LDK 25.24% dhe AAK 9.54%. Rezultatet e çertifikuara nga KQZ të zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Kosovës, 2014, fq. 2; shih: http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Rezu%20-%20Nivel%20Vendi%20-%20sipas%20subjekteve_peufawqvmc.pdf.

⁵⁰ *Ibid.* Lëvizja VETËVENDOSJE! i ka fituar 13.59% të votave, dhe NISMA 5.15%.

⁵¹ Shih rezultatet e partive të tjera, *ibid.*

⁵² Intervistë me Jakup Krasniqin, Kryetar i NISMA-s. Këtu, meqë ra fjala, është tejet domethënëse edhe një fakt tjetër. Një numër i madh i shqiptarëve të Kosovës ka rezerva ndaj Partisë Socialiste të Shqipërisë (që sot është në pushtet), jo aq për shkak të dallimeve ideologjike, por për shkak se atë e perceptojnë si një parti që, siç e thonë, "çështjen kombëtare nuk e kupton siç duhet."

⁵³ Nga intervista me Teuta Sahatçijën, zyrtare e lartë e LDK.

Rrjedhimisht, Kosova, që nga zgjedhjet e para pas luftës është qeverisur nga qeveri që kanë qenë koalicionet të udhëhequra, apo të përbëra, nga parti të djathta.⁵⁴ Si pasojë, gjatë gjithë kësaj periudhe, në Kosovë gara ideologjike mes partive të djathta dhe të majta, ose nuk ka ekzistuar fare, ose ka qenë fare e butë dhe e orientuar në çështje të dorës së dytë. Dhe kjo është një karakteristikë tjetër e skenës politike kosovare që profilizimin ideologjik të partive të saj e vështirëson jashtëzakonisht shumë. Thjeshtë, deri më tash, pak a shumë, nënkuptohet që e djathta do të qeverisë (madje edhe nëse mënyra e qeverisjes është e majtë), ndërkaq e majta do të jetë në opozitë, ose, në rastin më të mirë, ndonjëra nga partitë e majta mund edhe të ftohet për të marrë pjesë në aleancën qeverisëse. Dhe nëse rastis që procesi qeverisës të kërkojë herë pas here politika të majta, këto do të zbatohen nga partitë e djathta që janë në pushtet.

5. Drita në fundin e tunelit?

Ajo që është më e rëndësishmja lidhur me anëtarësimin e partive politike të Kosovës në organizimet evropiane dhe ndërkombëtare të partive politike është fakti i theksuar në të gjitha intervistat e zhvilluara që kohëve të fundit në këto parti është duke u rritur vetëdija, si për rëndësinë e profilizimit të mëtutjeshëm ideologjik, ashtu edhe për rëndësinë e këtij anëtarësimi. Lidhur me këtë, i kemi identifikuar dy faktorë kryesorë që kanë ndikuar në këtë vetëdijësim gjithnjë e më të madh. Së pari, ka qenë anëtarësimi i LDK-së në EPP, ku benefitet që LDK-ja i ka patur nga ky anëtarësim, te disa nga partitë e tjera e kanë krijuar në një masë të madhe bindjen që edhe ato detyrimisht duhet të anëtarësohen në organizime dhe asociacione të tilla. Mirëpo, një faktor tjetër edhe më i rëndësishëm për ngritjen e kësaj vetëdijeje ka qenë fakti që në Kosovë gjithnjë e më tepër flitet për perspektivat e anëtarësimin të Kosovës në Bashkimin Evropian. Pjesa më e madhe e qytetarëve të Kosovës e ka të qartë që anëtarësimi i Kosovës në BE do të jetë një proces shumë i gjatë dhe i vështirë, mirëpo që të gjithë e kuptojnë që ardhmëria e vetme e sigurtë e Kosovës është në BE. Kuptohet, këtë prirje të popullatës partitë politike të Kosovës e kanë kuptuar, dhe kjo, tekefundit, është edhe prirja e shumicës prej tyre. Prandaj, anëtarësitë e këtyre partive, përpjekjet e partive të veta për t'u anëtarësuar në organizimet dhe asociacionet e partive politike evropiane, gjithnjë e më tepër i konsiderojnë si një kontribut të rëndësishëm që ato mund ta japin në rrugën e Kosovës drejt BE-së. Ajo se sa do të jenë të suksesshme këto prirje të fuqizuara të partive politike të Kosovës për t'u anëtarësuar në organizimet dhe strukturat evropiane të partive politike do të varet nga përkushtimi i mirëfilltë i tyre për arritjen e këtij qëllimi.

⁵⁴ Përsëri, në vitin 2007 pushtetin e ka marrë PDK-ja që në atë kohë ka qenë ende e majtë, por që ishte në transformim e sipër për në një parti të djathtë.

Rekomandimet:

Integrimi i partive politike të Kosovës në organizatat ndërkombëtare të partive politike kërkon profilizim ideologjik, përkushtim politik, dhe kapacitete organizative për ta ndjekur këtë qëllim. Prandaj, partitë politike të Kosovës duhet t'i ndërmarrin veprimet në vijim për përshejtimin e këtij procesi:

1. Profilizimi ideologjik, si nga aspekti programor, ashtu edhe nga ai statutar, duhet t'i përshtatet kërkesave të organizatave përkatëse ndërkombëtare të partive politike.
2. Kapacitetet e brendshme për bashkëpunim ndërkombëtar duhet të fuqizohen për sa i përket personelit dhe financave, ashtu që të përshejtohen procedurat e domosdoshme për anëtarësim në organizatat përkatëse ndërkombëtare të partive politike.
3. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet lobimit me anëtarët e organizatave përkatëse ndërkombëtare të partive politike, ashtu që të fitohet përkrahja politike për anëtarësim.